VENDIM
Nr.780, datë 15.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KRAHËS TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Krahës të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Krahës, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.729, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Krahës, të qarkut të Gjirokastrës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komunat Krahës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Krahës Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-4	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
5-7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
8-20	Varrezat publike	Në pronësi
21-118	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
334-337,339-342, 344-347,349-353,355, 357-359,361-364, 366,368,369	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
338,343,348,354,356,360, 365,367,370, 727-736,372,376,379,383, 386,388,394,398,402	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
404-696	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
697-699	Prona që përdoren për ushtrimin e	Në pronësi

	funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	